

NJËSIA 1

Stereotipat dhe paragjykimet

**Çka është identiteti?
Si i perceptoj unë të tjerët,
si më shohin ata mua?**



1.1. Si e shohin të tjerët një person...

Personi është shumë më tepër se sa mund të mendojë dikush

1.2. Sa mund të përshkruhet ndryshe një person...

Si ta kuptojmë një person më mirë

1.3. Stereotipat dhe paragjykimet

Idetë tona për njerëz tjerë, grupe apo shtetet

1.4. Stereotipat për mua!

Si e shoh unë veten – si më shohin mua të tjerët?

NJËSIA 1: Stereotipat dhe paragjykimet

Çka është identiteti? Si i perceptoj unë të tjerët, si më shohin ata mua?

Kush jam unë në të vërtetë? Çdo ditë, nxënësit përjetojnë një llojllojshmëri të gjerë të vlerave dhe mënyrave të të jetuarit së bashku. Për të gjetur pozicionin e tyre, ata duhet të zhvillojnë aftësinë për të bërë zgjedhje. Çka mund të bëj unë, çka nuk duhet të bëj unë? Çka është e drejtë dhe çka është gabim? Fëmijët dhe adoleshentët shpejt e kuptojnë se këtyre pyetjeve nuk është lehtë për tu dhënë përgjigje. Çka mund të jetë e drejtë në një rast, mund të jetë gabim në rastin tjetër. Si mund të vendos? Çfarë udhëzimesh kam unë?

Dy mjete të rëndësishme për udhëzime personale janë kushtetuta e shtetit dhe qasja e saj ndaj të drejtave të njeriut. Këto janë dy pika të referencës që demonstrojnë pluralizmin e vlerave në një shoqëri. Parimi më i rëndësishëm është liria personale, e cila çdo individ i jep të drejtën e zhvillimit të personalitetit të tij ose të saj, kundruall një mjedisi shoqëror të tolerancës reciproke dhe të përgjegjësisë, duke sjellë kështu dobi për komunitetin në të cilin ai ose ajo jeton dhe për njerëzimin si tërësi. Ne mund të ndryshojmë shumë në pikëpamjet dhe interesat tona, me kusht që të jemi pajtuar për rregullat në bazë të të cilave do të diskutojmë në mënyrë paqësore për mosmarrëveshjet tona.

Fëmijët dhe adoleshentët duhet të dinë se të rriturit gjithashtu kacafyten me sfidat dhe kërkesat me të cilat ata ndeshen. Ata gjithashtu duhet ta dinë se mësimdhënësit nuk e kanë çelësin për të vërtetën absolute, por bëjnë gabime dhe përpiqen të mësojnë prej tyre.

Në këtë njësi mësimore trajtohen disa nga çështjet për zhvillimin e identitetit të individit dhe se si njerëzit dhe grupet e perceptojnë veten dhe të tjerët. Nxënësit duhet ta kuptojnë se identiteti i tyre përcaktohet nga vet ata dhe nga bashkëveprimi i tyre me të tjerët. Identiteti përcaktohet duke treguar dallimet ndërmjet individëve dhe nevojën për t'i takuar dhe për të qenë i mbrojtur nga familja apo nga një grup shokësh. Të rinjtë do ta kuptojnë veten më mirë nëse ata i shqyrtojnë ndjenjat dhe nevojat e tyre personale, zhvillimet e tyre personale dhe dëshirat për të ardhmen. Ata duhet të provojnë forma të ndryshme të sjelljes, duke zgjeruar kështu repertorin e tyre të bashkëveprimit me të tjerët. Ata do ta mësojnë këtë nëse situatave të bashkëveprimit shoqëror u kontribuojnë në mënyrë konstruktive.

Historia shoqërore dhe politike e shtetit tonë ka ndikim të fuqishëm në jetën tonë sot. Nxënësit duhet të jenë në dijeni për këtë ndikim duke mbledhur rregullisht informacione për çështjet aktuale dhe duke diskutuar për ato, duke krijuar mendimet e tyre personale dhe duke dëgjuar mendimet e të tjerëve. Ata duhet t'i kushtojnë vëmendje të matur pikëpamjeve, paragjykimeve dhe stereotipave të cilat janë pjesë e opinionit publik. Njeriu duhet të jetë i vetëdijshëm për këto forma të padukshme të ndikimit për të kundërvepruar ndaj tyre dhe për të reflektuar në mënyrë kritike mbi zgjedhjet e tij ose saj dhe, nëse është e nevojshme, për t'i ndryshuar këto zgjedhje.

Edukimi për qytetarinë demokratike dhe të drejtat e njeriut

Përmes kësaj serie të mësimëve nxënësit do të:

- njoftohen për konceptet e stereotipizimit dhe krijimin e paragjykimeve;
- kuptojnë se të gjithë ne vazhdimisht u atribuojmë kualitete të caktuara individëve dhe grupeve;
- kuptojnë se atribuimi i tillë na ndihmon të përballemi me kompleksitetin e jetës sonë të përditshme;
- kuptojnë se atribuimi mund të jetë i dëmshëm dhe i padrejtë;
- mësojnë se atribuimi ndihmon formimin e identitetit individual dhe atij të grupit;
- mësojnë se identiteti është gjë komplekse, dhe kjo do të thotë se çdo person mund dhe duhet të kuptohet dhe përshkruhet ndryshe.

NJËSIA 1: Stereotipat dhe paragjykimet

Çka është identiteti? Si i perceptoj unë të tjerët, si më shohin ata mua?

Titulli i mësimit	Objektivat e mësimmxënies	Detyrat e nxënësve	Burimet	Metoda
Mësimi 1: Si e shohin të tjerët një person	Nxënësit përballen me kompleksitetin e opinionëve dhe bëjnë zgjedhjet e tyre.	Nxënësve u caktohen role specifike dhe ata krijojnë opinionet e tyre. Ata mësohen si t'i ndërrojnë perspektivat.	Përshkrimi i roleve, prospektet e nxënësve 1.1 (grupet 1-3), fletë të mëdha të letrës, shënues (markera).	Punë në grupe
Mësimi 2: Sa ndryshe mund të përshkruhet një person	Nxënësit kuptojnë se përshkrimet e ndryshme mund t'i referohen njërit dhe identitetit të njëjtë.	Nxënësit përsërisin dhe aktrojnë skena dhe paraqesin punën e tyre me shkrim. Ata diskutojnë për skenat që i kanë parë.	Rezultatet e mësimit të parë bëhen material bazë për mësimin e dytë. Nxënësit kuptojnë se pa pjesëmarrjen dhe ndihmën e tyre, njësia nuk mund të vazhdohet.	Luajtja e roleve, prezantime dhe drejtimi i diskutimeve plenare
Mësimi 3: Stereotipat dhe paragjykimet	Nxënësit kuptojnë se si janë të lidhur stereotipat dhe paragjykimet dhe si ato mund të shpijnë në opinione të thjeshtësuara por edhe të padrejta për individët, për grupet e njerëzve dhe për shtete të tëra.	Nxënësit mendojnë mbi pikëpamjet e tyre për të tjerët dhe i diskutojnë ato në grupe.	Fletë të bardha të letrës dhe shënues (markera).	Punë në grupe, diskutime plenare
Mësimi 4: Stereotipat për mua!	Nxënësit informohen se si perceptohen nga të tjerët dhe mësohen që këtë ta pranojnë. Ata kuptojnë më mirë se si të tjerët e perceptojnë identitetin e tyre dhe reagojnë për këtë.	Nxënësit përshkruajnë veten dhe njëri tjetrin dhe ata i krahasojnë rezultatet e tyre.	Prospektet e nxënësve 1.2.	Punë në çifte, diskutime plenare

Mësimi 1

Si vështrohet një person nga të tjerët

Personi është shumë më tepër se sa mund të mendojë dikush

Objektivi i mësimnxënies	Nxënësit përballen me kompleksitetin e opinionëve dhe i bëjnë zgjedhjet e tyre.
Detyrat e nxënësve	Nxënësve u caktohen role specifike dhe ata krijojnë opinionet e tyre. Ata mësohen si të ndryshojnë perspektivën.
Burimet	Përshkrimi i roleve, prospektet 1.1 (grupet 1-3), fletë të mëdha të letrës, shënues (markera).
Metoda	Punë në grupe.

Mësimi

Nxënësit formojnë tri grupe dhe marrin prospektet për nxënës 1.1 (në tri versione të ndryshme për grupet e ndryshme), një fletë të madhe të letrës dhe shënues (marker). (Në klasat e mëdha mund të formohen më shumë grupe dhe mësimdhënësi atëherë siguron më shumë skena për lojë ose detyra e njëjtë u jepet grupeve të ndryshme. Kjo e fundit mund të jetë një skenar interesant, sepse do të tregojë se sa mund të jenë të ndryshme përshkrimet dhe të kuptuarit.) Pastaj mësimdhënësi e tregon tregimin e djaloshit që e ka ndërruar shtëpinë dhe është duke eksploruar mjedisin e tij të ri. Ai i tregon klasës për ditarin e djaloshit por atë nuk ia lexon klasës me zë, meqë çdo grup ka marrë vetëm një pjesë të tekstit.

Informacionet e prapaskenës vetëm për mësimdhënësit

Teksti i tërë është si vijon:

“Kjo është dita ime e parë në klasën e re. Familja ime ka ardhur këtu nga një rajon tjetër dhe unë akoma ndjehem si i huaj. I dashuri ditar, shumë gjëra më kanë ndodhur gjatë ditëve të fundit. Do të tregoj disa prej tyre.

Ne tani jetojmë në një banesë afër lumit. Njëri prej djemve të klasës jeton disa banesa larg meje. Ai erdhi tek unë që ditën e tretë të më ftoj të shkoj në peshkim me të. Unë i thash jo sepse grepi im është akoma i paketuar në njërin prej paketave.

Para objektit të shkollës sonë ndodhet një fushë e madhe futbolli. Unë u gëzova për këtë sepse më pëlqen të luaj futboll. Pra unë e solla topin me vete dhe doja të filloj stërvitjen. Posa kisha filluar të bëj një ose dy goditje në gol kur më ndali kujdestari i shkollës. Ai ishte i zemëruar dhe më pyeti nëse unë dija të lexoj apo jo. Unë nuk e kisha parë shenjën ku thuhej se fusha ishte e mbyllur pas shiut. U trondita aq shumë sa që shkova në shtëpi pa e thënë asnjë fjalë.

Një njeri i moshuar jeton i vetëm në banesën sipër nesh. Kur unë erdha në shtëpi dje, atë e takova në derën kryesore me gjësendet që i kishte blerë. Ai kishte një qese me ushqim dhe mbushej frymë thellë. Mua më erdhi keq për të, dhe e pyeta nëse mund t’i ndihmoja, dhe ia barta qesen deri tek dera e tij.”

Tri versionet e prospektëve për grupet përmbajnë pjesë të ndryshme të ditarit. Perceptimi i grupeve do të varet nga informacionet që ata i kanë marrë. Prandaj, çdo grup sheh vetëm një pjesë të identitetit të djaloshit dhe këtë opinion e reflekton në luajtjen e rolit. Ashtu siç kërkohet në detyra, grupet së pari paraqesin grupet e tyre të mbiemrave. Një anëtar i çdo grupi i mbledh rezultatet nga diskutimi në grup në një fletë të madhe të letrës për t’i prezentuar në mësimin e ardhshëm.

Tani çdo grup vendos për një rol të shkurtër të lojës që paraqet interpretimin e tyre. Luajtja e këtyre roleve së pari duhet të shpjegohet dhe të diskutohet në klasë dhe pastaj të përsëriten. Kjo mund të bëhet në kënde të ndryshme të klasës, ose ndoshta në sallat e mbledhjeve në objektin e shkollës, në objekte të jashtme ose, nëse këtë e lejon koha, në oborrin e shkollës. Edhe nëse luajtja e këtyre roleve merr pak kohë në fillim, mundi do t’ia vlejë. Për shumë nxënës, ajo çka është e vështirë për t’u shprehur me fjalë tani mund të thuhet thjeshtë dhe qartë.

Objekti i nxënësve në këtë mësim është që të shënojnë listën e mbiemrave në posterët dhe të përsërisin skenën.

Në fund të mësimit mësimdhënësi i mbledh posterët (ai i rishpërndan ato në fillim të mësimit të ardhshëm) dhe bën një rishqyrtim të shkurtër. Ai reagon pozitivisht dhe shikon temën për mësimin e ardhshëm.

Mësimi 2

Si mund të përshkruhet ndryshe një person...

Si të fitohet një portret më i mirë për personin

Objektivi i mësimnxënies	Nxënësit kuptojnë se përshkrimet e ndryshme mund t'i referohen po të njëjtë identitetit.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit përsërisin dhe luajnë skena dhe e paraqesin punën e tyre me shkrim. Ata i diskutojnë skenat që i kanë parë.
Burimet	Rezultatet e mësimi të parë (loja e përsëritur e roleve dhe listat e mbiemrave në postera) bëhen materiale bazë për mësimin e dytë. Nxënësit vërejnë se pa pjesëmarrjen dhe produktin e tyre, njësia nuk mund të vazhdohet.
Metoda	Luajtja e roleve, prezantime dhe drejtimi i diskutimeve plenare.

Mësimi

Pjesa 1

Mësimdhënësi e shpjegon procedurën e mësimi. Ai u jep grupeve edhe pesë minuta t'i përsërisin skenat e tyre. Pastaj paraqiten skenat.

Së pari, një anëtar i grupit ia lexon klasës shënimet nga ditari duke përdor posterin nga mësimi i parë. Pastaj grupi e luan skenën. Rekomandohet që të gjitha skenat të paraqiten pa ndërprerje. Nëse më shumë se një grup ka marrë shënimet e njëjta nga ditari, ata duhet t'i luajnë këto skena, me ndryshime të vogla, njëri pas tjetrit.

Pasi të kenë përfunduar grupet, mësimdhënësi reagon pozitivisht dhe sërish bën përmbledhjen e qëllimit të kësaj serie të skenave. Nëse klasa është e mësuar me këtë formë të mësimdhënies, atëherë nxënësit mund të vazhdojnë me hapin e ardhshëm. Nëse nuk vazhdojnë, rekomandohet që nxënësve tu jepet mundësia të rishikojnë dhe të reflektojnë serinë e skenave, duke u përqendruar në aspektet e përmbajtjes dhe formës.

Në vazhdim janë disa shembuj se si mësimdhënësi mund të nxisë përsiatjen për luajtjen e roleve:

- Cila ishte përvoja jonë si grup?
- A kam zbuluar unë diçka të re për mua?
- Si arritëm të paraqesim karakteret ashtu si ishin?

Pjesa 2

Gjatë pjesës së dytë të mësimi, nxënësit i rendisin karriget në një apo dy gjysmë rathë pranë dërrasës së zezë. Pastaj mësimdhënësi i vë posterët njërin pran tjetrit në dërrasën e zezë. Nxënësit shikojnë se si shtjellohet prezantimi:

Kështu më shohin mua të tjerët:

Shokët e klasës

Mësimdhënësit

Fqinjët

Në diskutimin që pason, nxënësit duhet të kuptojnë se është krejtësisht normale për një person të vështrohet ndryshe nga njerëz apo grupe të ndryshme. Ata duhet të kuptojnë se nuk mund të përdorin kategori siç është “e saktë” dhe “e pasaktë” për të përshkruar pikëpamjet. Në të vërtetë, për të vlerësuar djaloshin, do të ishte gabim nëse lejohet vetëm një pikëvështrim për ta përshkruar atë.

Nxitje të mundshme për mësimdhënësin që të mbështesë të menduarit kritik në klasë:

- Kur i shoh këto përshkrime të ndryshme ndjehem paksa i hutuar.
- Pra, çka është tani e vërtetë?
- Kush në të vërtetë është Max-i?

Mësimdhënësi pret derisa disa nxënës t'i ngritin duart dhe pastaj i lë ata të japin përgjigje të ndryshme. Këto përgjigje ai i shënon në një listë në dërrasën e zezë ose, më mirë, në tabelën shfletuese (flip chart):

Çka mund të themi për djaloshin?

- Si mund ta përshkruajnë atë në mënyrën e duhur?
- Formulimi 1
- Formulimi 2
- Formulimi 3
- Formulimi 4
- Formulimi 5

Në fund të mësimit mësimdhënësi përmbledh vështrimet që i ka nxjerrë nga nxënësit gjatë dy mësimeve të para. Do të ishte përparësi nëse kemi në dispozicion një tabelë shfletuese (flip chart) ku do të shënoheshin këto pika, ashtu që ato të paraqiteshin në mësime pasuese. Hollësitë vijuese mund të jenë të dobishme:

Identiteti

- Ekzistojnë shumë anë të identitetit të personit.
- Shpesh njerëzit tjerë (fqinjët, shokët, mësimdhënësit, të huajt) kanë pikëpamje shumë të ndryshme për personin e njëjtë.
- Ne duhet të dëgjojmë pikëpamje të ndryshme nëse duam të dimë më shumë për një person.
- ...
- ...

Në fund të mësimit, mësimdhënësi i pyet nxënësit për reagimet (informatat kthyese) e tyre, duke pasur kujdes që të mos komentojë vërejtjet e nxënësve.

Ka mënyra të ndryshme se si mund të bëhet kjo. Të pyesësh klasën si tërësi nuk është gjithmonë zgjidhja më e mirë sepse, më të shumtën e herës, do të përgjigjen ca nxënës të njëjtë dhe kundërpërgjigjja (informata kthyese) do të mbetet i (e) paspecifikuar. Prandaj, këtu rekomandohet modeli sipas lojës me gjuajtje në rreth (dartboard). Përmes kësaj metode marrim kundërpërgjigje (informatë kthyese) të shpejtë e cila çdo nxënës i mundëson të specifikojë përgjigjet e tij. Shtojca jep një përshkrim më të detajuar të kësaj forme të kundërpërgjigjeve (informatave kthyese).

Mësimdhënësi pastaj jep një vështrim paraprak të dy mësimeve të ardhshme, ku ora mësimore nuk do të përqendrohet në individ, por në grupe brenda shoqërisë dhe në shtete të tëra.

Mësimi 3

Stereotipat dhe paragjykimet

Idetë tona për njerëz tjerë, grupe ose shtete

Objektivi i mësimnxënies	Nxënësit kuptojnë se si janë të lidhur stereotipat dhe paragjykimet dhe si ato mund të na shpijnë në pikëpamje të thjeshtësuara por edhe të padrejta për individët, grupet e njerëzve dhe shtete të tëra.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit mendojnë për pikëpamjet e tyre për të tjerët dhe ato i diskutojnë në grupe.
Burimet	Fletë të bardha të letrës dhe shënues (markera).
Metoda	Punë në grupe, diskutime plenare.

Termet kyç

Stereotipat: Këto janë opinione që grupet i kanë për veten ose për grupet tjera.

Paragjykimet: Këto janë opinione të mbushur me emocione për grupe sociale (shpesh për pakicat) ose njerëz të caktuar (shpesh nga grupet e pakicave).

Mësimi

Objekti i këtij mësimi është që të aftësojë nxënësit të transferojnë të kuptuarit e tyre se si vëzhgohen të tjerët nga një nivel individual, në atë më të përgjithshëm, d.m.th. si vlerësohen grupet më të mëdha, komunitetet fetare, grupet etnike ose shtetet.

Mësimdhënësi përgatit një ligjëratë të shkurtër, të strukturuar qartë, për dallimin në mes të stereotipave dhe paragjytimeve të cilën e jep në fillim të mësimin.

Duke përmbledhur proceset e mësimnxënies dhe rezultatet e vështrimit e fituara nga dy mësimet e kaluara, mësimdhënësi ndihmon nxënësit të kuptojnë dallimin në mes të stereotipave dhe paragjytimeve. Mësimdhënësi i paraqet të dy konceptet duke iu referuar pikëpamjeve të ndryshme për djaloshin që u analizua në dy mësimet e mëparshme. Ai/ajo përpiqet që këto pikëpamje t'i paraqet si stereotipa dhe paragjytime (shih informacionet e prapaskenës për mësimdhënësin në fund të këtij kapitulli, ku është përfshirë një model për këtë ligjëratë të shkurtër kryesore). Në veprimin tjetër, nxënësit formojnë grupe të vogla. Ata punojnë në përshkrimin e grupeve sociale, për shembull:

- djemtë dhe vajzat;
- njerëzit e profesionit;
- grupet etnike;
- shtetet;
- kontinentet.

Është me rëndësi që nxënësit të mos i pyesim që të japin pikëpamjet e tyre personale për të tjerët. Përkundrazi, ata duhet të përfytyrojnë se çka mund të thonë ose mendojnë shoqëria, fqinjët ose mediet për grupet që u janë caktuar atyre në këtë detyrë.

Nxënësit përpiqen të bëjnë dallimin në mes të stereotipave dhe paragjytimeve, duke zbatuar atë që e kanë dëgjuar nga mësimdhënësi në fillim të mësimin.

Mësimdhënësi mund të jep disa udhëzime në dërrasën e zezë dhe nxënësit i përgatisin prezentimet e tyre për rezultatet e veta në formë të një liste. Përvoja ka treguar se një listë e përgatitur paraprakisht (shih shembullin më poshtë) do të ndihmojë nxënësit për të shënuar ide që më vonë t'i përdorin në diskutime.

Pas ligjëratës fillestare të mësimdhënësit për stereotipat dhe paragjykimet, nxënësit punojnë në grupe me tre apo katër vetë për rreth 15 minuta, që të reflektojnë për detyrën e sipërme. Mësimdhënësi me kujdes duhet të vlerësojë se cilin nga shembujt e sipërm të ofrojë. Varësisht nga situata politike në shtetin përkatës, mund të jetë e mundshme të zgjidhen shembuj të afërt me përvojën personale të nxënësit. Në anën tjetër, mësimdhënësi duhet të përmendi grupet etnike që jetojnë në atë shtet apo komunitet vetëm nëse, me një zgjedhje të tillë, nuk lëndohet askush, dhe vetëm nëse asnjë diskutim apo mosmarrëveshje që mund të dalë jashtë kontrollës të mos ketë gjasa të nxisë konflikt.

Diskusimet e grupeve dhe rezultatet duhet të paraqiten në sesion plenar. Çdo grup zgjedh një përfaqësues, i cili paraqet rezultatet e grupit duke ndjekur strukturën e kriterëve vijuese:

- shteti jonë, grupi jonë, prejardhja jonë etnike, profesioni jonë;
- stereotipat e shprehura nga grupi;
- paragjykimet e shprehura nga grupi;
- supozimet tona pse grupet kanë pikëpamje të tilla;
- opinionet tona, duke përfshirë edhe ndryshimet e mundshme të opinionëve.

Mësimdhënësi i ndihmon nxënësit duke regjistruar rezultatet e çdo grupi (në formë të shënimeve) në tabelën shfletuese (flip chart).

Shembull se si duhet shënuar rezultatet për të ndihmuar nxënësit:

Grupi	Shteti /njerëzit e profesionit/grupi	Stereotipat	Paragjykimet	Komentet
1				
2				
3				
4				
5				

Në fund, mësimdhënësi e bën përmbledhjen e mësimit, duke iu referuar edhe procedurës edhe rezultateve, dhe njofton klasën për hapat e ardhshëm.

Mësimi 4

Identiteti: Stereotipat për mua!

Si e shoh unë veten – si më shohin të tjerët mua?

Objektivat e mësimnxënies	Nxënësit kuptojnë se si ata perceptohen nga të tjerët dhe mësohen që këtë ta pranojnë. Ata kuptojnë më mirë se si të tjerët i shohin dhe si reagojnë ndaj identitetit të tyre. Ata studiojnë efektin që identiteti i tyre ka tek të tjerët.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit përshkruajnë veten dhe njëri tjetrin dhe i krahasojnë rezultatet e tyre
Burimet	Materialet e nxënësve 1.2.
Metoda	Punë në çifte. Diskutime plenare.

Mësimi

Mësimdhënësi e fillon mësimin duke përmbledhur rezultatet e dy mësimëve të mëparshme dhe duke shpjeguar programin për mësimin e sotëm.

Më pas mësimdhënësi përkujton nxënësit se ata kishin filluar duke parë një individ (gjendjen personale të një djaloshi) dhe pastaj kishin vazhduar të studiojnë se si perceptohen grupet më të mëdha, siç janë njerëzit e profesioneve, grupet etnike dhe shtete të tëra. Ata tani sërish do të përqendrohen në individin, por këtë herë vetë nxënësit – të gjithë në klasë – do të jenë fokusi. Ata do të përqendrohen në pyetjen:

Kush jam unë?	
Si do ta përshkruaja unë veten?	Vetperceptimi
Si do të më përshkruante mua një nxënës i klasës?	Perceptimi nga të tjerët

Mësimdhënësi e mbështet hyrjen që e bën për këtë mësim me vizatimin e kësaj tablele në dërrasën e zezë ose në tabelën shfletuese (flip chart). Ai ose ajo gjithashtu mund t'i pyes nxënësit të përsërisin atë çka kanë mësuar në dy mësimet e kaluara, për dallimin në mes të vetperceptimit dhe perceptimit nga të tjerët. Përveç kësaj, ose si një alternativë, ai mund të përsërisë konceptet kyçe të stereotipave dhe paragjytimeve.

Mësimdhënësi i merr prospektet e nxënësve duke treguar përshkrimet e nxënësve për Max-in. Kjo duhet t'ju ndihmojë nxënësve që të mendojnë për sa më shumë kualitete dhe karakteristika të njerëzve që të jetë e mundshme. Nxënësit kanë për detyrë që mundësisht të shënojnë sa më shumë mbiemra, të cilët mund të përdoren për të përshkruar një person. Për këtë çështje mësimdhënësi sigurisht se duhet tu jep disa ide dhe sugjerime. Për shembull, nxënësit mund të udhëzohen nga kategoritë që mbiemrave përshkruen u japin kuptim dhe qartësim. Kategoritë e tilla mund të përfshijnë si vijon:

Si do t'i përshkruanim njerëzit:

- nëse janë me humor të mirë?
- nëse janë pa humor apo janë edhe të inatosur?
- nëse janë shokë të mirë?
- nëse duam t'i përshkruajmë se si duken?
- nëse duam t'i përshkruajmë si nxënës?
- ...

Në vend se t'i pyesim disa nga nxënësit që të japin disa ide në një situatë të mësimdhënies frontale, duhet të përfshihet e tërë klasa. Kjo mund të arrihet përmes ushtrimit vijues,⁵ ku nxënësit bëjnë punë individuale për të dhënë shumëllojshmëri të ideve. Në qoshe të klasës ose në tavolina të veçanta, do të duhej të varen ose të shpërndahen fletë të mëdha të letrës. Në këto fletë, fjalët apo kategoritë e ndryshme kyçe janë dhënë si tituj. Nxënësit lëvizin nëpër klasë në qetësi dhe i shënojnë idetë e tyre në postera (më së mirë me shënues (marker) të siguruar për çdo poster). Meqë ata mund të lexojnë se çka kanë shkruar të tjerët, nxënësit nuk duhet të përsërisin njëri tjetrin, por mund të përgjigjen duke dhënë komente apo ide të reja.

5. Ushtrimi i sugjeruar këtu është një variant i "The Wall of Silence" (shih EQD/EDNJ Vëllimi VI, Developing New Ideas in EDC/HRE).

Rezultati i një ushtrimi të tillë mund të duket kështu:

Si duket një person kur është me humor të mirë?

- i gëzueshëm
- duke bërë shaka
- i çlodhur (relaksuar)
- komunikues
- duke kënduar
- magjepsës
- ...
- ...

Nuk ka nevojë për vazhdim në diskutimin plenar, meqenëse qëllimi i këtij ushtrimi është që nxënësve tu jep ide për të punuar në suaza të hapit që pason. Mësimdhënësi është dashur që të ketë parasysh se cilët nxënës mund të punojnë së bashku në çifte në këtë fazë. Kjo është e rëndësishme, sepse tema të cilën do ta trajtojnë nxënësit është delikate. Prandaj, mësimdhënësi duhet t'i shmanget vendosjes së bashku të nxënësve të cilët nuk e duan njëri tjetrin, dhe duhet të sigurohet që të mos lëndojnë ndjenjat e askujt.

Ekipeve u caktohet detyra vijuese:

Tani ju do të shqyrtoni se si e perceptoni veten dhe njëri tjetrin. Këtë duhet ta bëni sipas mënyrës vijuese:

- Së pari, punoni vetë.
- Shikoni përshkrimet e shumta në posterat në klasë dhe zgjidhni fjalët që, sipas mendimit tuaj, ju përshkruajnë juve plotësisht. Shënoni ato në prospekte.
- Shtoni cilësitë tuaja dhe përshkrimet për veten në situata të caktuara të cilat nuk i keni gjetur në postera. Shënoni ato në prospekte.
- Pastaj përshkruani partnerin tuaj në të njëjtën mënyrë.
- Kur ju të dy të keni përfunduar, komentoni bashkërisht rezultatet tuaja. Do të ishte interesante të shihni se cilat përshkrime dhe vlerësime përputhen dhe cilat ndryshojnë ose, madje, edhe kundërshtojnë njëra tjetrën. Shprehi mendimet dhe ndjenjat tua:
 - Çka më befason?
 - Çka më bën të lumtur?
 - Çka më zemëron?
 - Çka më lëndon?
 - A mund ta mbështetni vlerësimin tuaj me disa shembuj?
 - Cilat përshkrime janë stereotipa (pozitive apo negative)?

Mësimdhënësi duhet të vendosë nëse do të mbajë një sesion përfundimtar me pyetje dhe udhëzime në fund të këtij mësimi (që gjithashtu është edhe fundi i kësaj njësie, edhe pse vazhdimet janë të mundshme) apo do të përmbledhë procesin e mësimnxënies për katër mësimet e fundit. Cilëndo metodë që ai ta zgjedhë, ai do ta vërej se atmosfera e punës në klasë është përmirësuar gjatë kësaj

njësie. Nxënësit do të kenë zhvilluar marrëdhënie më të afërta me njëri tjetrin dhe do të kenë bërë zbulime interesante të cilat do t'i ndajnë me njëri tjetrin. Ata tani mund të bëjnë dallimin në mes të:

- stereotipave dhe paragjytimeve;
- vetperceptimit dhe perceptimit nga të tjerët.

Ata kanë përparuar në zhvillimin e aftësive të tyre shoqërore, nga të cilat do të përfitojnë në jetën e tyre të përditshme, në klasë por edhe në edukimin e tyre në tërësi. Nxënësit shpesh do të hasin në këto tema që janë paraqitur në këto katër mësimet, duke bashkuar kështu atë çka ata e kanë mësuar.

Prospektet e nxënësve 1.1

(Grupi 1)
Luajtja e rolit

Caktoni një përfaqësues të grupit tuaj i cili do të lexojë me zë shënimet e shkurtra nga ditari dhe detyrën për grupin tuaj.

Caktoni një anëtar tjetër të grupit tuaj i cili do të merr shënime të rezultateve tuaja dhe do t'ia paraqesë klasës.

Shënime nga ditari i Max-it:

“Kjo është dita ime e parë në klasën e re. Familja ime ka ardhur këtu nga një rajon tjetër dhe unë akoma ndjehem si i huaj. I dashuri ditari, shumë gjëra më kanë ndodhur gjatë ditëve të fundit. Do të tregoj disa prej tyre.

Ne tani jetojmë në një banesë afër lumit. Njëri prej djemve të klasës jeton disa banesa larg meje. Ai erdhi tek unë që ditën e tretë të më thotë të shkoj në peshkim me të. Unë i thash jo sepse grepi im është akoma i paketuar në njërin prej paketave.”

Detyrat:

1. Mblidhni një listë të mbiemrave të cilët mendoni se do t'i përdorin shokët e klasës së Max-it për ta përshkruar atë (stuhi mendimesh në grupin tuaj).
2. Çka mendoni se do t'u thotë një nxënës në klasën e Max-it nxënësve të tjerë për të? Përsëritni një skenë që mund ta luani në klasë.

Prospektet e nxënësve 1.1

(Grupi 2)
Luajtja e rolit

Caktoni një përfaqësues të grupit tuaj i cili do të lexojë me zë shënimet e shkurtra nga ditari dhe detyrën për grupin tuaj.

Caktoni një anëtar tjetër të grupit tuaj i cili do të merr shënime të rezultateve tuaja dhe do t'ia paraqesë klasës.

Shënime nga ditari i Max-it:

“Para objektit të shkollës sonë ndodhet një fushë e madhe futbollit. Unë u gëzova për këtë sepse më pëlqen të luaj futboll. Pra unë e solla topin me vete dhe doja të filloj stërvitjen. Unë posa kisha filluar të bëj një ose dy goditje në gol kur më ndali kujdestari i shkollës. Ai ishte i zemëruar dhe më pyeti nëse unë dija të lexoj apo jo. Unë nuk e kisha parë shenjën ku thuhej se fusha ishte e mbyllur pas shiut. Unë u trondita aq shumë sa që shkova në shtëpi pa e thënë asnjë fjalë.”

Detyrat:

1. Mblidhni një listë të mbiemrave të cilët mendoni se do ti përdorin shokët e klasës së Max-it për ta përshkruar atë (stuhi mendimesh në grupin tuaj).
2. Çka mendoni se do tu thotë një nxënës në klasën e Max-it nxënësve të tjerë për të? Përsëritni një skenë që mund ta luani në klasë.

Prospektet e nxënësve 1.1 (Grupi 3) Luajtja e rolit

Caktoni një përfaqësues të grupit tuaj i cili do të lexojë me zë shënimet e shkurtra nga ditari dhe detyrën për grupin tuaj.

Caktoni një anëtar tjetër të grupit tuaj i cili do të merr shënime të rezultateve tuaja dhe do t'ia paraqesë klasës.

Shënime nga ditari i Max-it:

“Kjo është dita ime e parë në klasën e re. Familja ime ka ardhur këtu nga një rajon tjetër dhe unë akoma ndjehem si i huaj. I dashuri ditari, shumë gjëra më kanë ndodhur gjatë ditëve të fundit. Do të tregoj disa prej tyre.

Një njeri i moshuar jeton i vetëm në banesën sipër nesh. Kur unë erdha në shtëpi dje, atë e takova në derën kryesore me gjësendet që i kishte blerë. Ai kishte një qese me ushqim dhe mbushej frymë thellë. Mua më erdhi keq për të, dhe unë e pyeta nëse mund t'i ndihmoja, dhe ia barta qesen deri tek dera e tij.”

Detyrat:

1. Mblidhni një listë të mbiemrave të cilët mendoni se do t'i përdorin shokët e klasës së Max-it për ta përshkruar atë (stuhi mendimesh në grupin tuaj).
2. Çka mendoni se do tu thotë një nxënës në klasën e Max-it nxënësve të tjerë për të? Përsëritni një skenë që mund ta luani në klasë.

Informacionet e prapaskenës vetëm për mësimdhënësit

Stereotipat dhe paragjykimet

Çka është stereotipi?

Njerëzit shpesh përkufizohen si pjesëtarë të grupeve, varësisht nga kultura e tyre, besimeve fetare, prejardhjes së tyre apo karakteristikave të jashtme siç janë ngjyra e lëkurës së tyre, madhësia, modeli i flokëve të tyre apo veshmbathja.

Shpesh ky përkufizim i grupeve shoqërohet me caktimin e kualiteteve të veçanta për njerëzit, ashtu që përfytyrimet specifike të mund të lidhen me grupe të caktuara. Nëse këto përfytyrime janë ekzagjeruar deri në atë masë, sa që vështirë mund të korrespondojnë me realitetin, të tillët i quajmë stereotipa.

Stereotipat mund të gjinden edhe në libra (madje edhe në tekste shkollore), vizatime komike, reklama ose filma. Ju sigurisht se edhe vetë keni hasur në stereotipa të tillë. Mendoni, për shembull, për përfytyrimin e një gruaje afrikane e cila ka të veshur fund të punuar nga gjethet e palmës, me buzë të trasha dhe eshtra të vegjël të ngjitur në hundë.

Nga stereotipi në paragjykim

Nëse një person apo grup vlerësohet duke u bazuar vetëm në stereotipat dhe jo si individ apo grup individësh, kemi të bëjmë me një paragjykim. Faktikisht, është krijuar një mendim për një person ose grup pa i njohur ata/ato. Pikëpamjet dhe idetë e tilla, shumë shpesh, nuk kanë të përbashkët asgjë me realitetin dhe ata shpesh janë të pafavorshme apo armiqësore.

Stereotipat “pozitiv”

Mirëpo, ka edhe stereotipa pozitiv. Për shembull, nëse dikush thotë se zezakët janë vrapues të shpejtë, këtë mund ta quajmë si stereotip pozitiv. Ju mund të mendoni “Po, çka ka të keqe në këtë?”. Por edhe në këtë rast, njerëzit, gabimisht, futen në një thes. Vetëm mendoni: a është vërtetë e saktë se të gjithë zezakët mund të vrapojnë shpejt?

Për çka janë të mirë stereotipat?

Paragjykimet duket se botën e bëjnë më të thjeshtë dhe më pak të komplikuar. Nëse njerëzit takojnë njerëz të tjerë të cilët duken të çuditshëm, ata shpesh e kanë ndjenjën e shqetësimin. Në situata të tilla, paragjykimet u mundësojnë njerëzve të fshehin shqetësimin e tyre – Unë mund të shtirem se di çdo gjë për tjetrin ose tjerët dhe se nuk kam nevojë të parashtrij pyetje. Por si rezultat, që nga fillimi, një takim i rastësishëm kuptimplotë dhe një mirëkuptim i vërtetë janë bërë të pamundshëm.

Cili është efekti i paragjykimeve?

Paragjykimet janë ofenduese. Ato kryesisht përdoren për të trajtuar dikë padrejtësisht. Paragjykimet i privojnë njerëzit nga mundësia për të treguar se kush janë ata dhe për çka janë të aftë. Për shembull, një punëdhënës mund të mos u ofrojë kandidatëve turq punë sepse ai ka dëgjuar se “ata” gjithmonë vinë në punë me vonesë. Disa njerëz mund të qepen pas paragjykimeve dhe ideve populiste edhe pse nuk e dinë askënd që mund të vërtetojë këto pikëpamje negative.

Çka mund të bëjmë kundër paragjykimeve?

Paragjykimet vështirë zhduken, prandaj edhe është vështirë për t’u marrë me to. Por nuk duhet të humbim shpresën: askush nuk ka lindur me paragjykimet. Ata janë mësuar dhe prandaj edhe mund të çmësohen (harrohen). Para se të vlerësoni një person, pyetni atë të shpjegojë pse ai ose ajo e ka bërë atë që është temë diskutimi. Mos harroni se ju me siguri nuk do të dëshironit t’ju vlerësojë dikush pa u dëgjuar.

Prospektet e nxënësve 1.2

Vetperceptimi – perceptimi nga të tjerët

Punë në çifte

Komete pas diskutimit - Ku harmonizohen pikëpamjet tona - Ku dallohen pikëpamjet tona - Vërejtjet	Si e përshkruaj unë veten (vetperceptimi)	Si e përshkruaj shokun tim të klasës (Perceptimi im për dikë tjetër i shkruar nga unë)	Komete pas diskutimit - Ku harmonizohen pikëpamjet tona - Ku dallohen pikëpamjet tona - Vërejtjet